



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.61/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Besart Ademi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Faton Hyseni nga Zvicra, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosove, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 20.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si i bazuar apeli Anr.61/2019 i datës 20.09.2019 Faton Hysenit, paraqitur kundër KQZ-së për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës, **URDHËROHET** KQZ-ja të përfshijë votuesin Faton Hyseni në listat e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 20.09.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Faton Hyseni nga Suedia, në të cilën pretendohet se nuk figuron në Listën përfundimtare për votues jashtë Kosovës edhe pse siq theksohet se aplikimin e ka bërë në afatet kohore me dokumentet me të cilat iu kan kërkuar. Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur edhe aplikacionin për regjistrim të pranuar nga KQZ-ja , formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës si dhe lejën e identifikimit.

Në përgjigjen në apel të datës 20.09.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se Aplikuesi Faton Hyseni ka dërguar kopje të dokumentit të identifikimit të Republikës së Kosovës së bashku me aplikacionin e regjistrimit brenda afatit të aplikimit për regjistrim si votues jashtë Kosovës, dhe i cili duhet të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

PZAP-i pas që shqyrtoj apelin vlerësoj se :

Apeli është i bazuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i bazuar pasi që parashtruesi i apelit si dëshmi ka bashkëngjitur dokumentin valid - lejen e njoftimit Nr.1170967018, të datës 16.06.2014, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës. Prandaj Paneli, ka konstatuar se apeli ka mbështetje ligjore në nenin 3.1, pika a), e Rregullës Zgjedhore nr.03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“Votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedhë fletëvotimin për zgjedhjet në bazë të procedurave që përcaktohen me këtë rregull të zgjedhjeve”*, pasi që në rastin konkret parashtruesi i apelit posedon dokumente valide të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës dhe njëherit i plotëson kriteret për të qenë pjesë e Listës së Votuesve.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 3, 118 par. 1, 122 par. 1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par. 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 61/2019 më datën 22.09.2019.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*